

V E N D I M

Nr. _____ Datë ____/____/ 2012

Mbi

Miratimin e Rregullores “Për organizimin dhe menaxhimin e Autoritetit Portual Durrës”.

Këshilli Drejtues në mbledhjen e tij të datës 15.10.2012 pasi mori në shqyrtim propozimin e paraqitur nga Drejtoria Ekzekutive, mbështetur në;

Ligjin Nr.9130, datë 08.09.2003, ”Për Autoritetin Portual”, neni 15 paragrafi 2,

VKM Nr.596, datë 10. 09. 2004, ”Për Miratimin e Statutit të Autoritetit Portual Durrës dhe për Riorganizimin e tij” neni 9 pika 2;

Vendimin e Këshillit Drejtues Nr 24 datë 15.03.2006 “ Miratimi i Rregullores së Këshillit Drejtues “, neni 16/2,

Vendimin e Këshillit Drejtues Nr 28 date 15.12.2011 “Per miratimin e Struktures Organizative, organogrames dhe numrit te punonjsve te APD” me ndryshimet përkatëse;

Me qëllim përcaktimin e organizimit, mënyrës së funksionimit të të gjitha strukturave përbërëse si dhe mënyrës së menaxhimit të Autoritetit Portual Durrës, në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe në përputhje me zhvillimet dhe projektet e implementuara ne APD.

V e n d o s i:

1. Miratimin e Rregullores “Për organizimin dhe menaxhimin e Autoritetit Portual Durrës” sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Drejtoria Ekzekutive e APD të marrë masat për nxjerrjen e urdhërave dhe udhëzimeve, në funksion të zbatimit të rregullores, dhe të hartojë përshkrimet e punës të cdo pozicioni në përputhje me Strukturën Organizative dhe kësaj Rregullore.
3. Ngarkohet Drejtoria Ekzekutive per zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARE

Iva CARA

KRYETARI

Ervin MINAROLLI

Anëtarët

Mirela HASANAJ

Genc MATAJ

Ylli DYLGJERI

Adrian ÇELA

Agim MAKSUTI